



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER
DREJTORIA E TOPOGRAFIKË DHE KËSHILLIMIT BUIQËSOR

Nr. 1107 Prot.

Fier, më 24.01.2025

Projekt - Vendim

Nr. 13 datë 24.01.2025

“Për miratimin e dhënies me qira të pasurisë nr. 9/10 zk. 3358 e llojit toke arë, ndodhur në fshatin Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, pasurisë nr. 4978 zk. 1273 e llojit toke arë, ndodhur në fshatin “Peshtan Bregas”, Njësia Administrative Frakull Bashkia Fier .

Në bazë të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit 8312 dt. 26.03.1998 “Për tokat bujqësore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo - territorial”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 770 dt. 14.11.2007 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Frakull Bashkia Fier Qarku Fier, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 363 dt. 01.04.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Topojë Bashkia Fier Qarku Fier, ligjit 8312 dt. 26.03.1998 “Për tokat bujqësore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”, **Kryetari i Bashkisë;**

PROPOZON

1. Të miratojë dhënien me qira të pasurisë nr. 9/10 zk. 3358 e llojit toke arë, me sipërfaqe 6660 m², ndodhur në fshatin Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier , pasurisë nr. 4978 zk. 1273 e llojit toke arë me sipërfaqe “14404 m², ndodhur në fshatin Peshtan Bregas Njësia Administrative Frakull Bashkia Fier, ne pronesi të Bashkisë Fier.
2. Ky proces të kryhet bazuar në ligjin 8312 dt. 26.03.1998 “Për tokat bujqësore”, i ndryshuar , Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”.
3. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave te metejeshme administrative ligjore.

Drejtoria e Topografisë dhe këshillimit bujqësor

Drejtori: F. Elezi

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtore: E. Kaplanaj

KRYETARI
Armando SUBASHI

